



Emër Mbiemër **JANI THOMAI**

Datëlindje **02.02.1935**

Vendlindje **Seman (Fier)**

Viti i zgjedhjes **2003**

Seksioni **Shkencat shoqërore dhe albanologjike**

Kontakt

Adresa zyrtare: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Sheshi "Fan S. Noli", 7, Tiranë; kutia postare 40.
Rruga "Zef Jubani", Hyrja 23, Apartamenti 14, Tiranë.

Telefon: Tel. fix: (04) 22 52 401; Celular: 068 20 15 167

Email: jthomai@yahoo.com

Faqe zyrtare: www.akad.gov.al

CV e shkurtër

Arsimimi: Shkolla e mesme pedagogjike në Shkodër (1950-1954); Shkolla e lartë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, dega e Gjuhës dhe e Letërsisë shqipe (1954-1958); diplomimi: me mbrojtje të tezës "*E folmja e katundit Seman*".

Sipas formimit filologjik në shkollën e lartë, në shkallën e parë e të dytë të kualifikimit pasuniversitar dhe të studimeve e të kërkimeve vetjake, fushat kryesore të hulumtimit shkencor kanë qenë: leksikologji shqipe, leksikografi shqipe (teori e hartim fjalorësh), frazeologji gjuhësore shqipe, semasiologji (semantikë leksikore), dialektologji, fjalëformim, kulturë gjuhe e standardizim etj. Vjeljet e fjalëve e të frazeologjisë nga të gjitha gjinitë e botimeve dhe mbledhja e tyre nga të gjitha të folmet e shqipes me ekspedita leksikologjike në terren, kanë shërbyer për njohjen e lëndës leksikore, frazeologjike e semantike të shqipes, për pasurimin e Kartotekës së leksikut të shqipes (sot me mbi pesë milionë skeda) dhe për hartimin e studimeve e të fjalorëve me lëndën e saj. Nga vetë objekti i studimit dhe nga synimet e hulumtimit vinte në radhë të parë përshkrimi e interpretimi i veçantive të gjuhës shqipe, shpesh në ballafaqim edhe me gjuhë të tjera, veçanti në formë e në përmbajtje. Është e kuptueshme kështu që studimet me objekt lëndën e shqipes kanë një shkallë më të lartë origjinaliteti, krahasuar me fusha të tjera, pikërisht për shkak të natyrës së vetë objektit të studimit, pa shpërfillur arritjet e gjuhësisë

botërore dhe të trashëgimisë sonë. Studimet teorike i kanë shërbyer pasurimit të dijeve shkencore për leksikun, frazeologjinë e semantikën leksikore të shqipes dhe kanë qenë burim kryesor për tekstet e shkollës së lartë për këto fusha, për hartimin e temave të diplomave të studentëve dhe të mikrotezave e të tezave të kualifikimit pasuniversitar (“Master”, “Doktor”). Fjalorët edhe më gjerë u kanë shërbyer përdoruesve të tyre, hartuesve të fjalorëve dygjuhësh me shqipen, studimeve për kategori leksikore e semantike etj., përveç që në çdo fjalor, siç dihet, përpunohet një sistem teorik shkencor, pa të cilin nuk mund të mendohet hartimi i glosarëve, zbërthimi kuptimor e ndërtimi i strukturave kuptimore të fjalëve, tipologjia e shpjegimeve, shtresimi i leksikut, elementet e mbishtresuara në semantikë etj. Kumtesat e diskutimet në veprimtari shkencore ndërkombëtare, ligjëratat për shqipen në vende të tjera dhe botimi i studimeve edhe në revistat e huaja, i shërbejnë së paku informimit të studiuesve të huaj, sidomos albanologë, për problemet e arritjet në fushat e përmendura të studimit.

Punësimi

Në Institutin e Historisë dhe të Gjuhësisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë, më pas: Departamenti i leksikologjisë dhe i terminologjisë (1958-2008); përgjegjës i Departamentit të leksikologjisë dhe të terminologjisë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë; kryetar i Seksionit të shkencave në Akademinë e Shkencave (2003-2008); Sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave (2008-2009); bashkëkryetar i Këshillit Ndërkademiq për Gjuhën Shqipe (që nga viti 2010)

Kualifikimi, titujt e gradat shkencore

Provime pasuniversitare për filozofi, gjuhësi e përgjithshme, albanologji, rusisht e frëngjisht (aspiranturë, 1963-1964); mbrojtja e tezës “Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe” për gradën “Kandidat i shkencave filologjike” (1967); mbrojtja e tezës “Prejardhja semantike në gjuhën shqipe” për gradën “Doktor i shkencave filologjike” (1984); titulli shkencor “Profesor” (1994); Anëtar i Akademisë së Shkencave (2003); “Doctor honoris causa” i Universitetit publik “Fan S. Noli” (Korçë, 26.03.2015).

Drejtues shkencor projektesh e redaktor shkencor: *Fjalorët shpjegues* (1980, 1984, 2002, 2006, 2012 - elektronik, 2014 - për shkollarët); *fjalorët frazeologjikë* shqip e ballkanik (1999); “Për pastërtinë e gjuhës shqipe (Fjalor) (1998); “Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe” (2004); “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” (I, II, 1972; III, 1989); “Shqiptarët e Maqedonisë” (1994); “Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë” (2005); “Fjalor me shprehje të huazuara në gjuhën shqipe” (hartuar nga A. Jashari, 2007); “Fjalor frazeologjik shqip-frëngjisht e frëngjisht-shqip” (hartuar nga Daniel Xhoxhaj, 2010); “Historia e popullit shqiptar” (hartuar nga Akademia e Shkencave, vëllimet I, II, III, 2002-2003) etj.

Anëtarësia në redaksi e në forume shkencore

Anëtar në redaksi të revistave shkencore: “Studime filologjike”, “Gjuha jonë”, “Gjurmime albanologjike”; në përmbledhje studimesh: “Studime mbi leksikun ...”, “Leksikografia shqipe ...” etj.; **Anëtar në forume shkencore:** Në Këshillin shkencor të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (1965-2008); në Asamblenë e Akademisë së Shkencave (2003-2009); në EURALEX (“Shoqata Europiane e Leksikografëve”), edhe si koordinator për Shqipërinë (që nga viti 1988 - shih “International Journal of Lexicography”, Volume 15, Number 1, March, 2002, f. 26 dhe 14); në Komitetin Kombëtar të AIESEE

(“Shoqata Ndërkombëtare e Studimeve të Europës Juglindore”) (2008-2009); në Këshillin e botimeve të Akademisë së Shkencave (2007-2010); në Këshillin Ndërkademi për Gjuhën Shqipe (Shqipëri – Kosovë, që nga viti 2005), edhe si bashkëkryetar (2010-2014) etj.

Dekorime

“Çmimi i Republikës” i shkallës së dytë (1984); Urdhri “Naim Frashëri” i klasit të parë (1985); “Qytetar nderi i Myzeqesë” (2001); “Qytetar nderi i rrethit të Fierit” (2008).

Veprimtari shkencore

Drejtues i 20 ekspeditave leksikologjike në Shqipëri e në Kosovë;

vjelje fjalësh, shprehjesh e kuptimesh nga rreth 100 000 faqe (letërsi artistike, publicistikë etj.);

kërkime bibliografike e arkivore në Francë, Austri, Angli, Itali, Rusi, Maqedoni;

pjesëmarrje me kumtesa a me referate në veprimtari shkencore ndërkombëtare: në Simpoziumin shkencor kushtuar N. Joklit (Innsbruck, Austri, 1977); në Kongresin VI ballkanik (Sofje, 1966); në Konferencat albanologjike (Tiranë, I, 1962; II, 1968); në Kongresin e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (edhe si delegat, 1972); në Kongresin XIV Ndërkombëtar të Linguistëve (Berlin, 1987); në Kongresin III të EURALEX-it (Budapest, 1988); në konferencën shkencore “Gjuha letrare shqipe dhe bota shqiptare” (1992); në Kongresin VI të EURALEX-it (Amsterdam, 1994); në “Table Ronde Balkanique” (Bansko, Bullgari, 1995); në Konferencën shkencore kushtuar A. Desnickajas (Sankt-Peterburg, 1995); në Kongresin IX të AIESEE (Tiranë, 2005); në Seminarin Ndërkombëtar të Albanologjisë në Tetovë (V, 2011; VI, 2012; VII, 2013; VIII, 2014), si dhe në shumë konferenca, simpoziume e sesione shkencore në Prishtinë, në Shkup, në Tetovë, në Tiranë, në Korçë, në Shkodër e në rrethe të tjera për çështje të ndryshme të gjuhës shqipe, për leksikon e frazeologjinë shqipe etj.; **ligjërata shkencore:** në Vjenë, San-Peterburg, Napoli, Tiranë, Prishtinë, Shkup, Korçë etj.

Veprimtari mësimore

Titullar i lëndëve “Leksikologjia e gjuhës shqipe” dhe “Semasiologjia leksikore” në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës (1958-2008), në Korçë e Prishtinë.

Publikime (Monografi, Vepra kolektive, Përmbledhje studimesh)

a) Fjalorë

1. *Fjalor i gjuhës së sotme shqipe* / bashkëhartues e bashkëredaktor, Tiranë, 1980, 2270 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: (B.m.) dhe (B.v.) 491.983-3 F 69

2. *Fjalor i shqipes së sotme* / bashkëhartues e bashkëredaktor, Tiranë, 1984, 1700 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN:

3. *Fjalor i shqipes së sotme* / bashkëripunues e redaktor i përgjithshëm, Tiranë, 2002, 1580 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99927 1 607X

4. *Për pastërtinë e gjuhës shqipe (Fjalor)* / bashkëhartues e bashkëredaktor, Tiranë, 1998, 188 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99927-600-0-1

5. *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* / autor, Tiranë 1999, 1170 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99927-654-4-5

6. *Fjalor frazeologjik ballkanik* (në pesë gjuhë: shqip – bullgarisht – greqisht – rumanisht – serbokroatisht) / drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor, Tiranë, 1999, 351 faqe; ISBN: 99927-31-72-9

7. *Fjalor sinonimik i gjuhës shqipe* / drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor, Tiranë, 2004, 1084 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99943-630-9-3

8. *Fjalor i gjuhës shqipe* / drejtues shkencor i projektit, bashkëhartues dhe redaktor shkencor, Tiranë, 2006, 1250 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99943-817-5-X

9. *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 2010, me rreth 10 000 njësi frazeologjike, 591 faqe, me një studim hyrës prej 61 faqesh (Akademia e Shkencave e Shqipërisë); ISBN: 978-9928-4037-1-1

10. *Fjalor elektronik i gjuhës shqipe* / bashkëhartues e redaktor shkencor, Tiranë, 2012, me rreth 50 000 fjalë

11. *Fjalor i gjuhës shqipe (për shkollat e mesme dhe klasat e larta të shkollës 9-vjeçare)* / bashkëhartues e redaktor shkencor, Tiranë, 2014, me rreth 35 000 fjalë (dorëshkrim)

b) Monografi e tekste të botuara

b1) Libra

1. *Leksikologjia shqipe* / autor, Prishtinë, 1970, 120 faqe (Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore);

2. *Leksikologjia e gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 1974, 250 faqe, (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë);

3. *Leksikologjia e gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 1999, 312 faqe (SHBLU); ISBN: 99927-0-045-9;

4. *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 1981, 330 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: (B.m.) 491.983-561(021) / (B.v.) 491.983-56 (021) Th 72;

5. *Leksikologjia e gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 1981, 364 faqe (SHBLU);

6. *Leksikologjia shqipe për shkollat e larta* / autor, Prishtinë, 1971, 117 faqe (Universiteti i Prishtinës);

7. *Leksikologjia shqipe për shkollat e larta* / autor, Prishtinë, 1978, 200 faqe (Universiteti i Prishtinës);

8. *Libri i gjuhës shqipe 3 (për shkollat e mesme)* / bashkautor e redaktor përgjegjës, Tiranë, 1983, 110 faqe (Shtëpia botuese e librit shkollor); ISBN: (B.m.) dhe (B.v.) 491.983 (075.2) + 491.983.30 (075.2) Th 72;

9. *Prejardhja semantike në gjuhën shqipe* / autor, Tiranë, 1989, 340 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 809.198.3-541.2 Th 72;

10. *Teksti dhe gjuha* (përmbledhje studimesh), 1992, 200 faqe (Shtëpia botuese e librit universitar);

11. *Semasiologjia leksikore* / autor, Tiranë, 1997, 100 faqe (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë);

12. *Leksiku dialektor e krahinor në gjuhën shqipe* / autor, Tiranë, 2001, 323 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99927-761-5-3;

13. *Leksikologjia e gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 2002, 314 faqe (SHBLU); ISBN: 99927-0-165-x;

14. *Veçori leksiko-semantike të ndajfoljeve me prapashtesa në gjuhën shqipe* / autor, Tiranë, 2004, 243 faqe (Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Sektori i leksikologjisë dhe i leksikografisë); ISBN: 99943-614-9-X;

15. *Leksikologjia e gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 2005, 300 faqe (Botimet “Dudaj”); ISBN: 99943-33-23-2;

16. *Leksikologjia e gjuhës shqipe* / autor, Tiranë, 2006 / 2011, 364 faqe (Botimet “Toena”); ISBN: 99943 1 208 1;

17. *Prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe (Semantikë leksikore)* / autor, Tiranë, 2009, 318 faqe (Akademia e Shkencave); ISBN: 978-999 56-776-2-6;

18. *Ligjërata pasuniversitare* / autor, Korçë, 2015, 183 faqe (Universiteti “Fan S. Noli”).

Vepra me bashkëpunim të pjesshëm

Fjalor i termave të gjuhësisë, 1975 (plotësimi i terminologjisë për leksikologji, leksikografi, frazeologji, semantikë e gjuhësi teorike);

Fjalor enciklopedik shqiptar, 1985 (hartimi 9 zërave për leksikologjinë e për leksikografinë shqipe, për gjuhëtarë etj.); *Fjalor enciklopedik shqiptar* (vepër e ripunuar rrënjësisht dhe në proces botimi; hartimi ose rihartimi i 10 zërave, 2007).

- Autor i shumë artikujve, recensioneve, kronikave shkencore dhe pjesëmarrës me kumtesa në shumë konferenca e simpoziume kombëtare e ndërkombëtare.